REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1906/5 prot. Tiranë, më 18.09.2026

V E N D I M

Nr. 38, datë 18.09.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Z. , gazetar pranë redaksisë "Media 60" (në vijim "ankuesi"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 1906 prot., datë 08.07.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik Agjencia "INOVATION4ALBANIA[1]" (në vijim "Autoriteti Publik" ose "Agjencia").

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion të datës 16.06.2026, depozituar në adresën elektronike zyrtare të koordinatores për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik (oriana.kocibelli@startupalbania.gov.al), ka kërkuar t'i vihet në dispozicion, në bazë të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dokumentacioni si më poshtë:

1. Kopje e projekt-propozimit dhe e dosjes së plotë të aplikimit, me të cilën subjekti "Nensi Kovaçi" (person fizik) është shpallur fitues në "Thirrjen për masa mbështetëse 2025", për përfitimin e grantit publik në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë.

2. Kopje e procesverbalit të vlerësimit, të hartuar nga komisioni/juria e ngarkuar me përzgjedhjen e këtij projekti, në të cilin pasqyrohet pikëzimi dhe argumentimi mbi shpalljen fitues.

[1] Ndryshuar emërtimi sipas Vendimit nr. 58, datë 28.01.2026 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë "INNOVATION4ALBANIA"

3. Lista e plotë e anëtarëve të bordit/komisionit të vlerësimit të thirrjes për grante të vitit 2025.

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave ligjore për rastet e refuzimit/ moskthimit të përgjigjes, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI-së.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në zbatim të pikës 3 të nenit 24 të LDI-së, si dhe në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1906/1 prot., datë 13.07.2026, i kërkoi Autoritetit Publik të informohej mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 16.07.2026.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 299/1 prot., datë 16.07.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1906/3 prot., datë 20.07.2026, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar se: *"Nga verifikimi i kryer në sistemin tonë elektronik të komunikimit rezulton se nga ankuesi, z. , në adresën zyrtare të email-it oriana.kocibelli@startupalbania.gov.al është paraqitur një kërkesë e vetme për informacion, e datës 08.07.2026. Kjo kërkesë është regjistruar, trajtuar dhe është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, konkretisht me email të datës 13.07.2026, bashkëlidhur kësaj shkrese për referencë dhe informim të plotë të institucionit Tuaj. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë kërkesë tjetër e paraqitur nga ana e ankuesit që të mos ketë marrë përgjigje nga Agjencia jonë. ... Mbi kërkesën për vënien në dispozicion të projekt-propozimit, dosjes së aplikimit dhe procesverbalit të vlerësimit të subjektit "Nensi Kovaçi" (Person Fizik) lidhur me këtë pjesë të kërkesës, ju bëjmë me dije se dokumentacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion, pasi përmban informacion që mbrohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi. Konkretisht, neni 17, pika 1, shkronja "b" dhe pika 3 e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet kur dhënia e informacionit dëmton sekretin tregtar, si dhe kur përhapja e tij do të cenonte sekretin profesional të garantuar nga ligji. Në rastin konkret:*

- *Projekt-propozimi dhe dosja e plotë e aplikimit përmbajnë informacion teknik, financiar, organizativ, metodologjik, si dhe elemente të modelit të biznesit të aplikantit, të cilët përbëjnë informacion konfidencial dhe sekret tregtar të subjektit aplikues. Vënia në dispozicion e këtij informacioni palëve të treta do të cenonte drejtpërdrejt interesat ligjorë të subjektit dhe do të dëmtonte pozitën e tij konkurruese në treg.*

- *Procesverbali i vlerësimit përmban vlerësime profesionale të ekspertëve dhe dokumentacion të brendshëm të procesit administrativ vlerësues, i cili mbrohet po ashtu në bazë të së njëjtës dispozitë ligjore, si dhe në zbatim të parimit të mbrojtjes së sekretit profesional.*

Mbi kërkesën për listën e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Thirrjes për Masa Mbështetëse 2025, në lidhje me këtë kërkesë, ju bëjmë me dije se bërja publike e identitetit të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit nuk gjen mbështetje në legjislacionin e posaçëm që rregullon thirrjen për masa mbështetëse me grant dhe, në kushtet e mungesës së pëlqimit të tyre paraprak, është në kundërshtim me nenin 17, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, sipas të cilit e drejta e informimit mund të kufizohet kur dhënia e informacionit cenon të drejtën për jetën private. Për më tepër, duke pasur parasysh përmasat e kufizuara të ekosistemit të startup-eve në Republikën e Shqipërisë, publikimi i identitetit të anëtarëve të Komisionit do të mund t'i ekspozonte ata ndaj: presioneve dhe ndërhyrjeve të papërshtatshme, ndikimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga palët e interesuara, formave të tjera të intimidimit apo konflikteve të mundshme. Një ekspozim i tillë do të cenonte rëndë pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit të vlerësimit, si dhe integritetin dhe besueshmërinë e procedurave të përzgjedhjes së përfituesve, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë dhe objektivitetin e vendimmarrjes së Komisionit. Në përmbyllje të sa më sipër, ju bëjmë me dije se Agjencia ka trajtuar me përgjegjshmëri dhe brenda afateve ligjore kërkesën e vetme të paraqitur nga z. më datë 08.07.2026, duke i kthyer përgjigje zyrtare me shkresën e datës 13.07.2026, të cilën po ia bashkëngjitim kësaj shkrese për informim të plotë. Në vijim të angazhimit tonë të vazhdueshëm për transparencë proaktive dhe zbatim rigoroz të legjislacionit në fuqi, sqarojmë se dokumentacioni i kërkuar, konkretisht projekt-propozimi, dosja e plotë e aplikimit dhe procesverbali i vlerësimit i subjektit "Nensi Kovaçi" (Person Fizik), si dhe lista e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Thirrjes për Masa Mbështetëse 2025, nuk mund të vihet në dispozicion, për shkak të kufizimeve të shprehura shprehimisht në nenin 17, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", si dhe pika 3, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar".

Ndërkohë, ankuesi, me *email*-in e datës 13.07.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1906/2 prot., datë 13.07.2026, ka vijuar ankimin duke u shprehur se: *"Më datë 16 qershor 2026 i kemi kërkuar Agjencisë kopjen e projekt-propozimit dhe dosjes së aplikimit me të cilën subjekti "Nensi Kovaçi" është shpallur fitues për grantin prej 4 milionë lekësh, procesverbalin e vlerësimit, përfshirë pikëzimin dhe argumentimin, si dhe listën e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit. Për shkak se Agjencia nuk dha përgjigje brenda afatit ligjor, më datë 8 korrik 2026 depozituam ankesë pranë institucionit tuaj. Pas ankesës, Agjencia na dërgoi një përgjigje me të cilën refuzon dhënien e informacionit të kërkuar, duke pretenduar se dosja përmban sekret tregtar dhe profesional, ndërsa identiteti i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit përbën të dhënë private.*

Përgjigjja e vonuar nuk e ka bërë ankesën pa objekt, madje hezitimi fillestar është pasuar nga një refuzim, ndaj kërkoj që shqyrtimi administrativ të vazhdojë edhe mbi ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e këtij refuzimi. Refuzimi i Agjencisë është i përgjithshëm dhe nuk përmban analizë konkrete se cilat pjesë të secilit dokument përbëjnë sekret tregtar, çfarë

dëmi real do të sillte publikimi dhe përse ky dëm do të ishte më i rëndë se interesi publik për transparencën e përdorimit të fondeve shtetërore. Thjesht cilësimi i të gjithë dosjes si "konfidenciale" nuk përmbush kërkesat e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014, i ndryshuar. Edhe nëse pjesë të kufizuara të projekt-propozimit përmbajnë elemente teknike, financiare ose të modelit të biznesit që mund të mbrohen, Agjencia kishte detyrimin të vendoste në dispozicion pjesën tjetër të dokumentacionit, duke redaktuar vetëm elementet konkretisht të mbrojtura. Nuk mund të refuzohet në bllok i gjithë aplikimi, formulari i pikëzimit, argumentimi i vlerësimit dhe dokumentet administrative. Gjithashtu, pretendimi se procesverbali përmban "vlerësime profesionale" nuk është i mjaftueshëm për ta kthyer automatikisht atë në sekret profesional. Agjencia nuk ka treguar ligjin e posaçëm që garanton një sekret të tillë dhe as se përse pikët dhe arsyetimi i një procedure të përfunduar të shpërndarjes së parave publike duhet të mbeten të fshehta. Edhe refuzimi i identitetit të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit nuk është proporcional. Kërkesa nuk ka objekt adresat, numrat e telefonit apo të dhëna të jetës private, por emrin, funksionin dhe cilësinë zyrtare të personave që kanë marrë pjesë në një proces vendimmarrës për shpërndarjen e fondeve publike. Mungesa e pëlqimit të tyre nuk mund të jetë, në vetvete, arsye e mjaftueshme për fshehjen e ushtrimit të një funksioni zyrtar. Interesi publik për dhënien e informacionit është veçanërisht i lartë. Sipas dokumentacionit që disponojmë dhe që kërkoj të merret në shqyrtim, përfituesi Nensi Kovaçi është person i lidhur (termi që përdoret sipas ligjit) me znj. Florensa Kovaçi, administratore e shoqërisë "Durana Tech Park", në pronësi të Korporatës Shqiptare të Investimeve, kompani publike e lidhur me institucionet përgjegjëse për ekonominë dhe inovacionin. Në këtë rast, këto rrethana përbëjnë indicie që justifikojnë transparencë dhe kontroll publik më të lartë mbi përzgjedhjen, pikëzimin dhe vendimmarrjen për grantin".

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u mbajt më datë 28.07.2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Autoritetit Publik dhe të ankuesit.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe në vijimin e saj. Përfaqësuesit e Autoritetit Publik, për pikat 1 dhe 2 të saj, u shprehën se do të rivlerësonin qëndrimin e tyre dhe për këtë qëllim iu la një afat 2-javor, ndërsa për pikën e tretë të kërkesës rikonfirmuan qëndrimin refuzues të mbajtur në shkresat e sipërcituara, pa paraqitur elemente të reja faktike apo juridike në lidhje me këtë pikë. Pas kalimit të këtij afati, Autoriteti Publik nuk vendosi në dispozicion informacionin apo qëndrimin përfundimtar të tij.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të palëve dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson si më poshtë.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet*

e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia "INOVATION4ALBANIA" ushtron funksione publike administrative, ndër të cilat administrimin dhe shpërndarjen e fondeve publike (grante) për mbështetjen e sipërmarrjeve inovative dhe rrjedhimisht përmbush në mënyrë kumulative kriteret ligjore për t'u konsideruar "autoritet publik" dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, në rastin konkret Agjencia, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Neni 23 i Kushtetutës e njeh të drejtën për informim si të drejtë themelore kushtetuese. LDI, si ligj zbatues i kësaj norme, promovon parimin e "hapjes maksimale" (*maximum disclosure*), sipas të cilit çdo kufizim i aksesit në informacionin publik përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i transparencës dhe, si i tillë, i nënshtrohet interpretimit të ngushtë e jo ekstensiv. Ky parim gjen mbështetje edhe në standardet ndërkombëtare të fushës, ndër to Rekomandimi Rec(2002)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Mbi aksesin në dokumentet zyrtare", si dhe Konventa e Këshillit të Evropës nr. 205 "Për aksesin në dokumentet zyrtare" (Tromsø, 2009), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 45/2022. Në këtë kuadër, zbatimi i kufizimeve të së drejtës për informim kërkon një vlerësim konkret dhe të individualizuar të kushteve ligjore të zbatueshme për secilën kategori kufizimi, përfshirë, sipas rastit, domosdoshmërinë, proporcionalitetin, ekzistencën e dëmit ndaj interesit të mbrojtur dhe peshimin me interesin publik për dhënien e informacionit.

Në të njëjtën frymë, pika 6 e nenit 17 të LDI-së sanksionon shprehimisht detyrimin e aksesit të pjesshëm: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".* Kjo dispozitë detyron autoritetin publik të kryejë një identifikim analitik, dokument për dokument dhe, kur është e nevojshme, paragraf për paragraf, të elementeve konkrete që përbëjnë objekt kufizimi, duke përjashtuar kategorikisht refuzimin në bllok, të pambështetur në një analizë specifike proporcionaliteti. Ky standard korrespondon plotësisht me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit çdo kufizim i një të drejte duhet të jetë i domosdoshëm, i përshtatshëm dhe në raport të drejtë me qëllimin legjitim të ndjekur.

Për sa i përket refuzimit të dhënies së projekt-propozimit, dosjes së aplikimit dhe procesverbalit të vlerësimit (pikat 1 dhe 2 të kërkesës), nga shqyrtimi i përgjigjeve të kthyera nga Autoriteti Publik (shkresat e datave 13.07.2026 dhe 16.07.2026),

Komisioneri konstaton se refuzimi është formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte, pa u shoqëruar me identifikimin konkret të elementeve që përbëjnë, sipas pretendimit, "sekret tregtar" apo "sekret profesional". Referimi i thjeshtë te natyra "teknike, financiare, organizative, metodologjike" e dokumentacionit, pa specifikuar cilat pjesë saktësisht dhe për çfarë arsye përbëjnë informacion për të cilët e drejta e informimit kufizohet, nuk plotëson standardin e kërkuar nga pika 6 e nenit 17 të LDI-së, as testin e proporcionalitetit të trajtuar më sipër.

Për sa i përket procesverbalit të vlerësimit, Komisioneri thekson se ky dokument, në thelbin e tij, nuk pasqyron të dhëna të gjeneruara nga vetë subjekti privat aplikues, por rezultatin e ushtrimit të një funksioni publik vlerësues nga vetë Autoriteti Publik (nëpërmjet komisionit të ngritur për këtë qëllim), në kuadër të një procedure publike të shpërndarjes së një fondi buxhetor/publik. Pikëzimi, argumentimi dhe motivimi i vendimit për shpalljen e fituesit përbëjnë dokumentacion administrativ të vetë institucionit, që lidhet drejtpërdrejt me llogaridhënien e tij për mënyrën e ushtrimit të kompetencave publike, dhe, si i tillë, nuk mund të konsiderohet, si rregull i përgjithshëm, "sekret profesional", në kuptimin restriktiv të pikës 3 së nenit 17 të LDI-së. Zbatimi i këtij kufizimi kërkon që informacioni të përbëjë sekret profesional të garantuar nga ligji dhe nuk mund të mbështetet vetëm në faktin se vlerësimi është kryer nga persona me kompetencë profesionale. Autoriteti Publik nuk ka identifikuar dispozitën konkrete ligjore që garanton si sekret profesional informacionin e përmbajtur në procesverbalin e vlerësimit.

Në rastin konkret, interesi publik për dhënien e informacionit merr peshë të shtuar, për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes që lidhen me fondet publike dhe shumën e përfitimit, si dhe ekzistojnë të dhëna, të parashtruara nga ankuesi dhe të paadresuara në mënyrë të posaçme nga Autoriteti Publik, që sugjerojnë lidhje të mundshme mes përfituesit dhe subjekteve të tjera me interes në fushën e ekonomisë dhe inovacionit. Këto rrethana e vendosin çështjen brenda kategorisë së informacionit "me interes të veçantë publik", për të cilin standardi i kontrollit dhe i transparencës duhet të jetë maksimal, në funksion të nxitjes së integritetit dhe të parandalimit të përdorimit të parregullt të fondeve publike, qëllim i sanksionuar shprehimisht në pikën 3 të nenit 1 të LDI-së.

Për më tepër, duhet të mbahet në konsideratë se një pjesë e rëndësishme e informacionit të sipërcituar lidhet edhe me detyrimin për publikimin nga Agjencia të informacionit në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 844, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve", në shkronjën "f" të pikës 3 të Kreut I, ku parashikohet se: *"3. Agjencia harton dhe publikon në faqen e saj të internetit: f) vlerësimet përfundimtare të projekt-propozimeve, të kryera nga komisioni i vlerësimit dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për inovacionin".*

Rrjedhimisht, Autoriteti Publik ka detyrimin të rishqyrtojë dokumentacionin objekt kërkese dhe të vërë në dispozicion të ankuesit formularin e aplikimit, projekt-propozimin, si dhe procesverbalin e vlerësimit me pikëzimin dhe argumentimin përkatës, duke

redaktuar (anonimizuar), vetëm kur provohen konkretisht kushtet e shkronjës "b" të pikës 1 së nenit 17 të LDI-së, në respektim të parimit të aksesit të pjesshëm, sanksionuar në pikën 6 të po këtij neni.

Lidhur me refuzimin e dhënies së identitetit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit (pika 3 e kërkesës), fakt për të cilin Autoriteti Publik pretendoi se bërja publike e identitetit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit cenon të drejtën për jetën private, në kuptim të shkronjës "a" të pikës 1 së nenit 17 të LDI-së, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Si fillim, sillet në vëmendje dispozita kushtetuese e paragrafit të dytë të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon se: *"2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore".*

Anëtarët e komisionit i ushtrojnë detyrat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve dhe inovacionit", i ndryshuar, ku parashikohet se: *"4. Me qëllim vlerësimin e kërkesave nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve ngrihet komisioni i vlerësimit dhe komisioni i ankimit. Ministri përgjegjës për inovacionin cakton kryetarët e këtyre komisioneve, rregullat e hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".*

Kërkesa e ankuesit është shprehimisht e kufizuar në emrin, funksionin dhe cilësinë zyrtare të personave që kanë marrë pjesë në ushtrim të funksionit të tyre publik, në një proces vendimmarrës për shpërndarjen e fondeve shtetërore. Ky informacion lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e detyrës publike dhe jo me sferën private të individëve. Kërkesa nuk përfshin të dhëna që lidhen me jetën private të tyre, si adresa e banimit, numri personal i telefonit, gjendja civile, kontaktet personale apo informacione të tjera që nuk kanë lidhje me funksionin publik të ushtruar.

Bazuar në pikën 4 të nenit 14 të ligjit nr. 25/2022, është miratuar Vendimi nr. 844 datë 30.12.2025, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve". Përbërja dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit është përcaktuar nga Kreu IV i këtij vendimi ku, ndër të tjera, parashikohet se: *"1. Komisioni i Vlerësimit dhe Komisioni i Ankimit, duke caktuar edhe kryetarët përkatës, ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për inovacionin sa herë që shpallet një thirrje për financim dhe/ose masë mbështetëse. Komisionet funksionojnë deri në përfundimin e detyrës së tyre, por jo më vonë se data e miratimit të listës së përfituesve nga ministri përgjegjës për inovacionin. ...3. Drejtori i Agjencisë është anëtar i Komisionit të Vlerësimit për shkak të detyrës".*

Sa më sipër, rezulton se të paktën për një anëtar, drejtorin e Agjencisë, i cili është anëtar i Komisionit të Vlerësimit për shkak të detyrës, pretendimi i Autoritetit Publik nuk qëndron pasi, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja "d", të LDI-së dhe Urdhrin nr. 280, datë

30.12.2025 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, informacioni mbi këtë anëtar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë. Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *"Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet ... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime".*

Sa i takon anëtarëve të tjerë, që janë subjekte të parashikimeve të mësipërme, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, por në zbatim të nenit 7 të LDI-së duhet që ta bëjë atë publik në mënyrë proaktive në Programin Institucional të Transparencës.

Zyra e Komisionerit thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër joshtetëror, që ushtron funksione publike. Emrat e nëpunësve civilë të emëruar në pozicionet e tyre të përhershme të punës, apo persona të tjerë të caktuar si anëtarë të një grupi pune apo komisioni, lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve zyrtare dhe jo me sferën e jetës së tyre private. Prandaj, këto subjekte, për shkak të natyrës së funksionit që ushtrojnë dhe rolit të tyre në shërbim të interesit publik, i nënshtrohen një niveli më të lartë transparence në lidhje me veprimtarinë e tyre zyrtare.

Në këtë kontekst, sjellim në vëmendje se Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, ku emrat e nëpunësve civilë/zyrtarëve publikë, qoftë në pozicionet e tyre të përhershme, apo qoftë kur janë ngarkuar me detyra në organe kolegjiale, janë konsideruar informacion publik. Këto vendime janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun https://www.idp.al/vendime-informimi/. Ndër to përmendim vendimet nr. 23, datë 13.04.2021; nr. 50, datë 17.11.2021; nr. 56, datë 01.12.2022; nr. 4, datë 17.03.2022; nr. 19, datë 15.05.2023; nr. 1, datë 07.02.2025; nr. 17, datë 20.06.2025; nr. 21, datë 15.06.2026 etj.

Ndërkaq, sipas parimeve të konsoliduara në të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, të dhënat që lidhen ekskluzivisht me ushtrimin e një funksioni apo detyre publike nuk gëzojnë të njëjtin nivel të lartë mbrojtjeje si të dhënat e sferës private të individit. Në kuptim të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim LMDHP), e dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash. Pika 23 e po të njëjtit nen përcakton se: *""Subjekt i të dhënave" është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë,*

lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror".

Emri dhe funksioni i një zyrtari që merr pjesë në një proces publik vendimmarrës mbi shpërndarjen e fondeve buxhetore, nuk përbën "të dhënë private" të mbrojtur, por informacion që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit publik dhe që i nënshtrohet, si i tillë, regjimit të transparencës dhe kontrollit publik mbi veprimtarinë e administratës.

Kjo pasi vetë LMDP-ja përmban një parashikim të veçantë në pikën 2 të nenit 44 të tij, ku parashikon se: *"Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh".*

Për më tepër, pretendimi i Autoritetit Publik se duke pasur parasysh përmasat e kufizuara të ekosistemit të startup-eve në Republikën e Shqipërisë, publikimi i identitetit të anëtarëve të Komisionit do t'i ekspozonte ndaj "presioneve, ndërhyrjeve të papërshtatshme apo formave të tjera të intimidimit", mbetet një pohim abstrakt e hipotetik, i pambështetur në fakte apo rrethana konkrete, të identifikuara e të provuara në rastin specifik, siç kërkohet nga standardi i "dëmit real dhe të provueshëm", i domosdoshëm për themelimin e çdo kufizimi sipas nenit 17 të LDI-së. Përkundrazi, për shkak të numrit të kufizuar dhe rolit të madh të këtyre personave në procedurat që lidhen me përdorimin e fondeve publike, publikimi i identitetit dhe funksionit të anëtarëve të një komisioni vlerësues publik shërben pikërisht si garanci e paanshmërisë, e pavarësisë dhe e integritetit të procesit të përzgjedhjes, duke mundësuar kontrollin publik mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, element me rëndësi të veçantë në rrethanat konkrete të çështjes, ku ankuesi ka parashtruar indicie mbi lidhje të mundshme mes përfituesit të grantit dhe subjekteve të tjera private me interes në sektor.

Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se qëndrimi refuzues i mbajtur nga Autoriteti Publik, si në tërësinë e tij, ashtu edhe në secilën prej pikave të kërkesës për informacion, nuk përmbush standardet ligjore të parashikuara nga LDI, si për sa i përket detyrimit për të kryer një test individualizuar dëmi/proporcionaliteti (neni 17, pikat 1, 3 e 6). Informacioni i kërkuar, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, përbën "informacion publik", pasi është e dhënë e regjistruar, e prodhuar dhe e administruar nga Autoriteti Publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik dhe rrjedhimisht i nënshtrohet, si rregull, aksesit publik, me përjashtim vetëm të atyre elementeve specifike që provohen konkretisht si objekt i një kufizimi ligjor legjitim e proporcional.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit

nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës nr. 1906 prot., datë 08.07.2026, të z. , kundër Autoritetit Publik Agjencia “INOVATION4ALBANIA”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të ankuesit të dokumentacionit të kërkuar me kërkesën për informacion të datës 16.06.2026, brenda datës 25.09.2026, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, vetëm për sa i përket dokumentacionit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të kërkesës.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 18.09.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi